



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

AD/GJTHPE/.nr.10/24

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarës I.C.S, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga avokate V.B, nga P..., pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 02.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET ankesa disiplinore e parashtruar nga avokate V.B nga P..., ndaj gjyqtarës I.C.S, **SI E PABAZUAR**.

A r s y e t i m

Me datë 14.08.2024, avokate V.B, nga P..., përmes adresës elektronike ka parashtruar ankesën disiplinore ndaj gjyqtarës I.C.S, për shkak të sjelljeve denigruese dhe të papershtatshme si dhe jo proporcionale me integritetin profesional dhe personal të gjyqtarës, thekson se me datë 13.08.2024 ka qenë e ftuar përmes telefonit nga zyrtarja ligjore që të përfaqsoj në çështjen penale P.nr.507/21 ndaj të pandehurit I.R, e ftuar sipas detyres zyrtare, në seancë kanë qenë të pranishëm prokurori i shtetit E.D, zyrtarja ligjore e gjyqtarës, i pandehuri I.R i sjellur nga policia pasi që ndaj tij është lëshuar urdhërarrest, eksperti i psikiatrisë N.P i cili u largua pas dhenies së ekspertizes, gjyqtarja I.C.S, si dhe e njejta si avokate mbrojtese e të pandehurit. Parashtruesja e ankesës ka theksuar se gjatë tërë seances gjyqtarja ka pas sjellje denigruese ndaj avokates në atë mënyrë që sa herë ka pas të drejtën e fjalës ajo ka qesh pa u ndalur, kjo sjellje nuk është aplikuar për të pranishmit tjerë mirëpo vetëm ndaj saj, me këtë sjellje të gjyqtarës e ndien vetën të ofenduar personalisht dhe degradim të punës së avokatit duke mos pasur asnjë arsye për një sjellje të tillë, për më tepër tentativa me ngulm të nxisë edhe prokurorin e shtetit që të qesh çdo rast kur ka pasur të drejtën e fjalës sipas saj nuk ka qenë rastesi e qeshura por ka qenë e qellimshme nga ana e gjyqtarës, gjatë fjalës hyrese nga ana e avokates i ka tërhequr vërejtjen duke i thënë "*gjyqtare çka ka me qesh*", mirëpo gjyqtarja vazhdon prap duke e dekoncentruar gjatë gjithë seances. Përfundimisht, e njëjta ka shtuar se në perfundim të seances pas nenshkrimit të procesverbalit, e pyet gjyqtaren edhe një herë se pse ke ajo e qeshur gjatë seances, gjyqtarja u përgjigj citoj: "*ti po don me më tregu mu se a ekzistojn kushtet mu mbajt seanca*", kjo për arsye se avokatja si mbrojtese e të pandehurit gjatë fjalës hyrese ka deklaruar se nuk mund të mbahet seanca pa praninë e të demtuarit. Andaj nga të lartcekurat konsideron se sjellja e tillë e një gjyqtari është denigruese, jo në proporcion me integritetin së pari personal dhe aq më pak profesional me institucionin e gjyqtarit, si dhe denigrim

i pozitës dhe punës të paraparë me dispozita ligjore të vet avokatit, andaj kërkon nga ana e kryetarit të gjykatës marrjen e masave ndaj gjyqtarës në fjalë në përputhje me dispozita ligjore të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar të Republikës së Kosovës.

Me datë 14.08.2024, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore të parashtruar nga avokate V.B, ndaj gjyqtarës I.C.S.

Me qëllim të vlerësimit të veprimeve të gjyqtarës I.C.S autoriteti kompetent i është drejtuar me Kërkesë për dhënie të deklaratës Prokurorit të Shtetit E.D, i cili ka qenë në përfaqësim të aktakuzës dhe prezentë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të udhëhequr nga gjyqtarja, që të deklarohet lidhur me fjalët dhe veprimet e gjyqtarës dhe të personave tjerë të pranishëm në këtë seance dhe çdo detaj tjetër lidhur me rastin.

Po ashtu, autoriteti kompetent i është drejtuar edhe zyrtarës ligjore pranë zyrës së gjyqtarës D.M, me Kërkesë për dhënie të deklaratës për rastin e ndodhur, fjalët dhe veprimet e gjyqtarës dhe të personave tjerë të pranishëm në këtë seance dhe çdo detaj tjetër lidhur me rastin, pasi që në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 13.08.2024 ka qenë prezentë në cilësinë e procesmbajtëses.

Gjithashtu, autoriteti ka marrë deklaratën me shkrim nga gjyqtarja I.C.S lidhur me sjelljen dhe veprimet e saj në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 13.08.2024.

Kryetari i Gjykatës, duke vepruar brenda kompetencave dhe autorizimeve si autoritet kompetent, me qëllim të vlerësimit për shkelje të mundshme disiplinore nga ana e gjyqtarës, me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar provat si në vijim:

Deklaratën e dhënë me shkrim me datë 28.08.2024, të zyrtarës ligjore D.M, në të cilën e njëjta ka përshkruar se me datën 13.08.2024 është informuar nga zyrtarët Stacionit Policor në Pejë që është arrestuar sipas Urdhërarrestit i pandehuri I.R dhe i njëjti pas pak është sjell në zyrë, e ka telefonuar avokaten dhe informuar për arrestimin dhe ka kërkuar që të paraqitet në gjykatë për seancën e shqyrtimit gjyqësor, e njëjta është paraqitur në zyrën e gjyqtarës duke ju drejtuar *“kur ja fillon seanca, pse m’thirre me ardh kaq shpejt”*, ndërsa e ka njoftuar se janë duke e pritur ekspertin e psikiatrisë N.P. Tek fjala hyrëse avokatja i është drejtuar gjyqtarës *“qysh po don me mbajt seancën e shqyrtimit gjyqësor kur nuk ke kushte”*, për çka gjyqtarja ka reaguar duke i thënë që gjatë dhënies së fjalës hyrëse nuk mund të udhëzoj gjykatën se a janë plotësuar kushtet ligjore për mbajtjen e seancës, pasi që gjykata veç se ka konstatuar se kushtet janë plotësuar dhe gjykata kujdeset për atë pjesë dhe për gjithë rrjedhën procedurale, edhe përkundër kësaj ka vazhduar me pretendime se nuk ka kushte. Tutje deklaroi se gjuha e përdorur nga av. V.B gjatë gjithë rrjedhës se seancës ka qenë jo profesionale, jo etike dhe me tendencë të përplasjes si dhe gjatë gjithë kohës gjyqtarja është munduar që të udhëzoj që të fokusohet në procedurë pasi që vazhdimisht ka ndërhyrë me kritika dhe udhëzime se çfarë dhe si duhet të veprojë gjykata. Thekson, se avokatja ka nënshkruar procesverbalin pa vërejtje dhe pas përfundimit të seancës i është drejtuar në formë të urdhrit *“ti*

bomi gati faturat për seancën e sotme dhe për një seance tjetër, unë vi i marr”. Ndërsa lidhur me pretendimet e avokates lidhur me kinse të qeshurën e gjyqtares nuk qëndron, pasi që e njëjta nuk ka parë sjellje të tillë nga gjyqtarja, përkundrazi gjyqtarja në çdo procedurë udhëheqë në mënyrë të pavarur, paanshme, konform dispozitave ligjore ndërsa sjellja e avokates lë shumë për të dëshiruar jo vetëm në raport me gjyqtaren por edhe me të njëjtën si zyrtare ligjore.

Deklaratën e dhënë me shkrim me datë 28.08.2024, nga Prokurori i Shtetit E.D, ku deklaron se lidhur me pretendimet e parashtrueses së ankesës, të njëjtat si prokuror dhe person prezent në shqyrtim gjyqësor nuk qëndrojnë. Përkundër, vëmendjen e të njëjtit në kuptim negativ e ka tërhequr paraqitja, sjellja dhe mungesa e profesionalizimit të avokates në fjalë. Tutje thekson se sa i përket sjelljes së gjyqtares, si prokurorë në rastin konkret si dhe raste tjera, asnjëherë nuk ka vërejtur sjellje të cilat cenojnë integritetin personal e as profesional të gjyqtares, përkundrazi e njëjta ka pasqyruar sjellje të larta të etikës profesionale dhe morale dhe ka ofruar garanci për të drejtat e palëve dhe pjesëmarrësve në procedure penale. Përfundimisht, deklaron se vëren një tendencë të palëve dhe pjesëmarrësve, me theks të veçantë avokatëve, që në forma të ndryshme të sjelljes të cenojnë pozitën e gjyqtarit.

Gjyqtarja I.C.S, në deklaratën e saj të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtrueses së ankesës ka deklaruar se një ankesë të tillë e konsideron plotësisht si të pabazuar, pretendimet e së njëjtës cenojnë rëndë profesionin e pavarur të gjyqtarit si dhe gjuha e përdorur është joprofesionale dhe e pakuptueshme, dhe nuk kuptohet se ku ishte baza e ankesës së parashtrueses. Ka shtuar se po të kishte qenë siç pretendon ankuesja si gjyqtare fare nuk do të kishte qenë në gjendje që të udhëheqë seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe që sjellja e supozuar patjetër do ishte vërejtur edhe nga palët prezent, thekson se mbrojtësja procesverbalin e seancës e ka nënshkruar pa vërejtje. Gjithashtu, e njëjta ka shtuar se ankuesja që nga fillimi i seancës ka pasur sjellje jo profesionale, me tendencë të përplasjes, mirëpo gjatë gjithë kohës është munduar që të njëjta të udhëzojë që të fokusohet në procedurë, pasi që ankuesja vazhdimisht ka ndërhyrë me kritika dhe udhëzime se çfarë dhe si duhet të veproj gjykata. Thekson se lidhur me pretendimin se a duhet të vazhdohet apo jo me shqyrtim dhe se nuk ka kushte, ju ka drejtuar se gjykata sipas detyrës zyrtare kujdeset për këtë pjesë. Në fjalën hyrëse ankuesja përsëri ka qenë e shpërqendruar, fjala hyrëse e saj nuk ishte konform dispozitës se nenit 324 të KPPRK-së, për çka gjykata ka reaguar duke i thënë që gjatë dhënies së fjalës hyrëse nuk mund të ndërhyjë në punën e gjykatës dhe atë me qasje të tensionuar, se a janë plotësuar kushtet ligjore për mbajtjen e seancës, pasi gjykata veç e ka konstatuar se kushtet janë plotësuar për mbajtjen e shqyrtimi. Mirëpo e njëjta ka vazhduar të insistoj se nuk ka kushte duke mos mbështetur insistimin e tillë në fakte dhe dispozita ligjore, shton se edhe përkundër kësaj si gjyqtare është treguar tolerante dhe nuk i ka tërhequr vërejtje duke shpresuar përqendrimin e saj në procedurë. Thekson se në seancën ku sipas ankueses pretendohet që ka pasur shkelje të Kodit të Etikës, prezentë kanë qenë Prokurori i Shtetit E.D, zyrtarja ligjore D.M, të cilët mund të dëshmojnë mbi mënyrën e sjelljes dhe veprimet e ndërmarra nga e njëjta si gjyqtare dhe avokatja në fjalë, prezent ka qenë edhe zyrtari policor, që nuk i kujtohet se cili ka qenë. Konsideron se në të tilla raste, pretendimet duhet të gjejnë mbështetje në argumente, e jo si në rastin konkret ankuesi të supozojë mbi veprimet e paqena, duke mos shpjeguar se me çka ndërlidhen veprimet e

tilla, pasi që në cilësinë e gjyqtares është kujdesur që palët të trajtohen me dinjitet dhe konstatimet janë të bartura edhe në procesverbal. Tutje, e njëjta shton se është treguar tolerantë me sjelljet e vrazhda të avokates, ku ankuesja pas përfundimit të seancës, zyrtares ligjore i është afuar tek tavolina e punës dhe me qasje komanduese i ka thënë t'ia përpiloj formularët për kompensim menjëherë, dhe nuk i'a ka tërhequr vërejtjen. Përfundimisht, shton se ankesa e parashtruar ka karakter personal si shenjë revolte në udhëzimet e mija të bazuara, duke parashtruar ankesë, e një ankesë e tillë është e pabazuar, dhe mbetet vetëm reflektim i sjelljes së pahijshme të parashtrueses dhe sulm në integritetin tim personal dhe profesional, andaj propozon që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Autoriteti kompetent me kujdes dhe përkushtim të veçantë analizoj të gjitha deklaratat e mësipërme, si të vetmet prova në këtë procedurë disiplinore në vlerësim të sjelljes së gjyqtares në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 13.08.2024 dhe pas vlerësimit të tyre ka gjetur se ankesa disiplinore është e pabazuar.

E njëjta si gjyqtare ka pasur sjellje korrekte, profesionale dhe ka udhëhequr seancën e shqyrtimit gjyqësor në pajtueshmëri me dispozitat ligjore. Faktet e tilla u vërtetuan nga deklaratat e zyrtares ligjore, prokurorit së rastit dhe vetë gjyqtares. Përtej rrethanave të lartcekura, autoriteti kompetent me asnjë provë të vetme nuk ka mundur të vërtetojë se gjyqtarja I.C-S ka pasur sjellje denigruese ndaj avokates duke qeshur sa herë që e njëjta ka pasur fjalën në seancën e shqyrtimit gjyqësor.

Pretendimi se gjyqtarja gjatë tërë rrjedhjes së seancës gjyqësore ka pasur sjellje denigruese ndaj avokates në atë mënyrë që sa herë ka pas të drejtën e fjalës ajo ka qesh pa u ndalur, pretendimi që gjyqtarja ka tentuar që të nxis edhe prokurorin e shtetit që të qesh si dhe pretendimin se gjyqtarja i është përgjigjur "*ti po don me më tregu mu se a ekzistojn kushtet mu mbajt seanca*", këto pretendime nuk janë mbështetë me asnjë provë dhe nuk janë argumentuar në asnjë mënyrë nga ana e parashtrueses të ankesës, dhe si të tilla mbeten vetëm supozime të palës ankuese, e duke u mbështetur edhe mbi faktin që procesverbalin e seancës avokatja e ka nënshkruar pa vërejtje. Pra, në procesverbalin gjyqësor të datës 13.08.2024 nuk konstatohet asnjë vërejtje e avokates së të pandehurit apo palëve në procedurë në lidhje me sjelljen e gjyqtares, andaj për Kryetarin e Gjykatës si Autoritet Kompetent, mbeten të paprovuar pretendimet e tilla.

Pretendimet e tilla u mohuan edhe nga zyrtarja ligjore e cila ka qenë prezentë në seancën e datës 13.08.2024 në cilësinë e procesmbajtëses, nga prokurori i rastit, të cilët në deklaratat e tyre mohuan të kenë parë sjelle denigruese të gjyqtares në raport me avokaten, përkundrazi të njëjtit potencia se gjyqtarja ka pasqyruar sjellje të larta të etikës profesionale dhe morale.

Prokurori i rastit në deklaratën e tij, e mohon që të këtë parë ndonjë sjellje denigruese të gjyqtares ndaj avokates së të pandehurit dhe thekson se vëmendjen e të njëjtit në kuptim negativ e ka tërhequr paraqitja, sjellja dhe mungesa e profesionalizimit të avokates në fjalë. Thekson se sa i përket sjelljes së gjyqtares, si prokurorë në rastin konkret si dhe raste tjera, asnjëherë nuk ka vërejtur sjellje të cilat cenojnë integritetin personal e as profesional të gjyqtares.

Tutje, edhe në deklaratën e dhënë nga zyrtarja ligjore D.M, e mohon pretendimet e avokates lidhur me kinse të qeshurën e gjyqtares, pasi që e njëjta nuk ka parë sjellje të tillë nga gjyqtarja, thekson se gjuha e përdorur nga av.V.B gjatë gjithë rrjedhës se seancës ka qenë jo profesionale, jo etike dhe me tendenca të përplasjes si dhe gjatë gjithë kohës gjyqtarja është munduar që të udhëzoj që të fokusohet në procedurë pasi që vazhdimisht ka ndërhyrë me kritika dhe udhëzime se çfarë dhe si duhet të veprojë gjykata.

Andaj, mbi bazën e të lartcekurave autoriteti kompetent gjeti se ankesa disiplinore mbështetet vetëm në supozime të cilat nuk janë mbështetë në asnjë provë të vetme dhe si të tilla nuk përbëjnë shkak të argumentuar për të mbështetur dyshimin se gjyqtarja ka kryer shkelje të natyrës disiplinore.

Autoriteti kompetent vlerëson se ankesa disiplinore në përgjithësi paraqet pakënaqësitë e shprehura nga avokatja e të pandehurit, këtu parashtruesja e ankesës, ndaj veprimeve të marra nga gjyqtarja me qëllim të drejtimit të procedurës, veprime këto të cilat nuk hyjnë në domenin e shkeljeve të natyrës disiplinore, pasi veprimet e tilla procedurale të gjyqtares janë subjekt i vlerësimit të gjykatave të shkallëve më të larta, si gjykata kompetente për vlerësimin e saktësisë dhe ligjshmërisë së vendimeve të gjyqtarëve.

Nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenin 7 par.3 pika 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, AD/GJTHPE/.nr.10/24, me datë 02.09.2024.

Kryetari i Gjykatës

Armend Berisha

Vendimi i dorëzohet:

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtares I.C.S*
- 3. Parashtrueses së ankesës- Avokate V.B*